



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 16.03.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Mufera Shinik, Milka Vuletiq, Sasha Milosavljević, Slavko Simić, Qerim Bajrami dhe Veton Berisha.

Munguan: Agim Kikaj, Fisnik Ismaili, Rrustem Berisha dhe Danush Ademi.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje : përfaqësuese e IDK-së - Qëndresa Mrasori, përfaqësuese e Ambasadës së SHBA-së në Kosovë - Maja Marković, konsultant i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi i Drejtorisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun - Celal Iliaz,

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Diskutim lidhur me mbështetjen e projektit të KDI-së, në fushën e hulumtimit legjislativ;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Diskutim lidhur me mbështetjen e projektit të KDI-së, në fushën e hulumtimit legjislativ

Kryesuesja, në kuadër të planit të punës për këtë vit, Komisioni duhet të zhvillojë aktivitetet e tij në bazë të afateve kohore.

Në takimin e sotëm është ftuar përfaqësuesi i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), për t'i ofruar përkrahje Komisionit në fushën e hulumtimit legjislativ. Në bazë të marrëveshjes me KDI-në, ata do të ofrojnë hulumtime dhe ekspertiza profesionale, të dhëna dhe alternativa për materien e ligjeve.

Si çështje tjetër, do të diskutohet për vizitën studimore në Kuvendin e Kroacisë, e cila vizitë do të realizohet në muajin maj. Për detaje më të hollësishme, do të njoftohemi nga përfaqësuesi i OSBES-së.

Sa i përket mbështetjes së projektit të KDI-së, për procedimin e monitorimit të Ligjit për shërbimin civil, konkretisht neni 11, Komisionit i nevojitet ndihma e tyre për gjetjen e të dhënave konkrete në terren, përfaqësimi i komuniteteve në institucionet publike. Për detaje të hollësishme, fjalën ia dha përfaqësueses së KDI-së.

Qëndresa Mrasori, theksi se organizata e KDI-së mbështet punën e komisioneve parlamentare, që nga viti 2014. Qëllimi kryesor është që të ngrihet cilësia e legjislacionit, përmes hulumtimeve parlamentare. Projekti i KDI-së, ka për qëllim të ofrojë ekspertiza në procesin e monitorimit të ligjeve me ç' rast do të angazhojë ekspert individual apo institute hulumtuese nga lëmi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve. Ekziston komisioni në përbërje të IND-së, Kuvendit dhe KDI-së, dhe varësisht nga kërkesat, mund të përzgjidhen tre persona, të cilët janë të përafërt me kërkesën e Komisionit. Hulumtimet do të mund të jenë nga aspekti i praktikave ndërkombëtare, të cilat janë praktikatat më të mira në rajon.

Duhet të specifikohen kërkesat e Komisionit, të nënshkruhet nga kryetarja e Komisionit, më pas të procedohet në Drejtorinë për Hulumtime, tek Arben Loshi. Kërkesa e definuar procedohet në KDI, bëhet përzgjedhja e ekspertëve për kohën që Komisioni kërkon. Eksperti do t'u përgjigjet kërkesave të Komisionit në çdo kohë, dhe në fazën e fundit, do të organizohet dëgjim publik.

Kryesuesja ishte e mendimit që hulumtimi legjislativ duhet të kryhet nga ana e ekspertit të KDI-së, në afat dyjavor. Ajo shtoi se Komisioni duhet të nënshkruajë kërkesë për hulumtim apo ekspertizën e Ligjit për shërbimin civil në Republikën e Kosovës, konkretisht nenit 11. Pas zhvillimit të procedurave, Komisioni do të dalë me raport final, i cili do të dërgohet për miratim në Kuvend.

Veton Berisha, si udhëheqës i grupit punues lidhur me monitorimin e Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe informatës se grupi punues është përcaktuar konkretisht për nenin 11, paraqet interesim që nga dita e nesërme të ketë takim me përfaqësuesit e KDI-së dhe administratën, për mbështetje të Komisionit, me qëllim që të procedohen çështjet aktuale për monitorimin e ligjit, si dhe të realizohen vizita të grupit punues në terren. Në kuadër të zhvillimeve procedurale, Komisioni do të dalë me rekomandime, të cilat do t'i inkorporojë në raport preliminar.

Qerim Bajrami, përshëndet mbështetjen e KDI-së, lidhur me monitorimin e punës së Komisionit, përfshirjen e organizatave joqeveritare, si dhe arritjen e koordinimit me grupin ndërministror.

Ai konsideron se fokusi i Komisionit është monitorimi i Ligjit për shërbimin civil, konkretisht neni 11. E përkrah bashkëpunimin e Vetonit me organizatën e KDI-së, i cili do t'i ofrojë informata për proceduarat e arritura, deri më sot lidhur me monitorimin e ligjit.

Sipas tij, nuk janë të vërteta të dhënat me numrin e të punësuarve, në bazë të 10 % për komunitetet. Ekziston numër i të punësuarve të komunitetit rom, boshnjak dhe kjo informatë nuk është e saktë, andaj kërkoj të gjendet modeli për identitetin e personave që punojnë në institucione publike. Kërkesa jonë është që këto vërejtje të identifikohen në raportin e Ligjit për shërbimin civil.

Kryesuesja, për detajet e realizimit të vizitës studimore në Kroaci, fjalën ia dha përfaqësuesit të OSBE-së.

Senad Karaahmetović, e njoftoi Komisionin për procedurat e realizimit të vizitës studimore në Kuvendin e Kroacisë. Gjithashtu, theksoi se OSBE-ja financon të gjitha shpenzimet e udhëtimit të delegacionit, për 8 anëtarë të Komisionit, ndërsa për anëtarët tjerë dhe administratën, mbetet të vendos Komisioni.

Ai propozoi dy afate kohore: më 15-17 maj 2016 dhe propozimi i dytë, më 29-31 maj 2016.

Gjithashtu, kërkoi nga anëtarët e Komisionit, të përcaktohen për datën e saktë të udhëtimit, me qëllim që të merret konfirmimi me shkrim nga Kuvendi i Kroacisë.

Pas konsultimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë

Përfundim

- I. Përkrahet propozimi i OSBE-së për realizimin e vizitës në Kuvendin e Kroacisë, për 8 anëtarë të delegacionit parlamentar.
- II. Anëtarët tjerë (4) të Komisionit dhe administrata për mbështetje të Komisionit (2), do të financohen nga buxheti i Komisionit.
- III. Anëtarët e Komisionit u pajtuan me datat e propozuara nga partneriteti i OSBE-së.

3. Të ndryshme

Kryesuesja, theksoi se në bazë të planit të punës, Komisioni do të ftojë ministrat që të raportojnë për çështjet e caktuara nga fushëveprimi i punës dhe përgjegjësia e Komisionit.

Ajo dha propozim konkret, që në takimin e radhës, të ftohet drejtori i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, pranë Zyrës së Kryeministrit.

Pas konsultimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë

Përfundim

Të ftohet drejtori i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, Ivan Tomiq, me qëllim që të raportojë lidhur me implementimin e Strategjisë së Qeverisë, që ka të bëjë me koordinimin e çështjeve për komunitetet në përgjithësi. Takimi do të mbahet ditën e martë, më 22.3.2016.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Jasmina Zhivković